

Para	<b>SKK 12 “EFEKTI I NDRYSHIMEVE TË KURSEVE TË KËMBIMIT” – PËRDITËSUAR (2023)</b>
	<b>OBJEKTIVI DHE BAZAT E PËRGATITJES</b>
1	Objekti i Standardit Kombëtar të Kontabilitetit 12 <i>Efekti i kurseve të këmbimit</i> (SKK12), miratuar nga Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit dhe shpallur nga ministri përgjegjës për financat, është dhënia e parimeve të njohjes, matjes e vlerësimit të mëposhtëm të transaksioneve në monedhë të huaj si dhe të shpjegimeve të nevojshme në pasqyrat financiare, të përgatitura në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit. Standardet Kombëtare të Kontabilitetit bazohen në parimet e kontabilitetit dhe raportimit financiar, të pranuar në shkallë ndërkombëtare, ku kërkesat e përgjithshme të të cilave përshkruhen në Ligjin për kontabilitetin.
2	SKK 12 është i krahasueshëm me Seksionin 30 <i>Përkthimi i Monedhës së Huaj</i> të Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar për Njësitë e vogla dhe të Mesme (SNRF për NVM). Një tabelë korresponduese e paragrafëve të këtij standardi paragrafë të SNRF për NVM (2015) është dhënë në paragrafin 35. Për rastet që nuk janë trajtuar në mënyrë të drejtpërdrejtë nga SKK 12 ose ndonjë SKK tjetër, drejtuesit e njësive ekonomike raportuese duhet që, me miratimin e Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit, të aplikojnë politika të tilla që sigurojnë një pasqyrim të vërtetë e të besueshëm të pozicionit financiar, performancës financiare dhe të fluksit të mjeteve monetare të njësive ekonomike, siç kërkohet në Ligjin për kontabilitetin.
3	Pasqyrat financiare do të përgatiten mbi bazën e konceptit të materialitetit. SKK nuk do të zbatohen për zërat jomaterialë. Parimi i materialitetit përkufizohet dhe sqarohet në paragrafët 64 deri 68 të SKK 1.
	<b>FUSHA E ZBATIMIT</b>
4	Ky standard do të zbatohet për: (a) trajtimin kontabël të transaksioneve dhe tepricave në monedhë të huaj; (b) përkthimin e rezultateve dhe pozicionit financiar të veprimtarive në monedhë të huaj të kryera jashtë vendit, që përfshihen në pasqyrat financiare të njësive, nëpërmjet konsolidimit të plotë ose modelit të kapitalit; (c) përkthimin e pasqyrave financiare në monedhën raportuese.  Kontabilizimi i instrumenteve financiare në monedhë të huaj trajtohet në përputhje me SKK 3 <i>Instrumentet Financiare</i> .
	<b>PËRKUFIZIMET KRYESORE</b>
5	Më poshtë jepen përkufizimet e disa termave kryesore që përdoren në këtë standard:  <u>Kursi i këmbimit të mbylljes</u> është kursi i këmbimit në datën e raportimit. <u>Diferenca nga kurset e këmbimit</u> është diferenca që vjen nga përkthimi i një shume të dhënë nga një monedhë në një monedhë tjetër (në lekë) me kurse të ndryshme këmbimi. <u>Kursi i këmbimit</u> është kursi, me të cilin këmben dy monedha të ndryshme. <u>Monedha e huaj</u> është çdo monedhë tjetër, përveç lekut. <u>Njësi ekonomike e huaj</u> është një njësi në formën e një shoqërie të kontrolluar, pjesëmarrje, sipërmarrje të përbashkët ose dege të njësive ekonomike, veprimtaritë e së cilës janë të bazuara ose kryhen në një vend të huaj dhe në një monedhë të ndryshme nga ajo raportuese e njësive ekonomike. <u>Grupi</u> përbëhet nga një shoqëri mëmë si dhe të gjitha njësitë e kontrolluara prej saj. <u>Zëra monetarë</u> janë mjetet monetare të njësive ekonomike, si dhe aktivet e detyrimet për t'u arkëtuar ose për t'u paguar me një numër të përcaktuar mjetesh monetare. <u>Investimi neto në një njësi ekonomike të huaj</u> është shuma e interesit të njësive ekonomike në aktivet neto të njësive ekonomike të huaj. <u>Kursi i këmbimit i menjëhershëm (spot)</u> është kursi i këmbimit për një lëvrim të menjëhershëm.
	<b>MONEDHA FUNKSIONALE</b>
6	Çdo njësi ekonomike duhet të identifikojë monedhën e saj funksionale. Monedha funksionale e një njësie ekonomike është monedha e mjedisit primar ekonomik në të cilin operon njësi ekonomike.
7	Zakonisht, mjedisi primar ekonomik në të cilin operon njësi ekonomike është mjedisi në të cilin ajo kryesisht gjeneron dhe shpenzon mjete monetare. Prandaj, në përcaktimin e monedhës së saj funksionale, një njësi ekonomike ka parasysh faktorët e mëposhtëm: (a) monedhën që kryesisht ndikon në çmimet e shitjes për mallrat, produktet dhe shërbimet (kjo shpesh do të jetë monedha në të cilën përcaktohen dhe paguhen çmimet e shitjes për mallrat, produktet dhe shërbimet e saj) si dhe monedhën e vendit, forcat konkurruese dhe rregullimet e tregut të cilat kryesisht përcaktojnë çmimet e shitjes së mallrave, produkteve dhe shërbimeve të saj; (b) monedhën që kryesisht ndikon në koston e punës, materialeve dhe kosto të tjera të ofrimit të mallrave dhe shërbimeve (kjo shpesh do të jetë monedha në të cilën përcaktohen dhe shlyhen kosto të tilla).
8	Faktorët vijues mundet gjithashtu të sigurojnë evidencë për monedhën funksionale të një njësie ekonomike:

	(a) monedha në të cilën gjenerohen fondet nga aktivitetet financuese (emetimi i instrumenteve të borxhit dhe të kapitalit); (b) monedha në të cilën merren zakonisht arkëtimet nga aktivitetet operative.
9	Faktorët vijues shtesë merren në konsideratë në përcaktimin e monedhës funksionale të një njësie ekonomike të huaj dhe në përcaktimin nëse monedha e saj funksionale është e njëjtë me atë të njësisë ekonomike ( në këtë rast, është njësia ekonomike që ka si filial të saj, degë, pjesëmarrje apo sipërmarrje e përbashkët njësinë ekonomike të huaj): (a) nëse aktivitetet e njësisë ekonomike të huaj janë më tepër një zgjatim i njësisë ekonomike, sesa aktivitete me një shkallë domethënëse autonomie. Një shembull i situatës së parë është kur njësia ekonomike e huaj vetëm shet mallra të importuara nga njësia ekonomike dhe i paguan asaj shumat e arkëtuara. Një shembull i situatës së dytë është kur njësia ekonomike e huaj akumulon mjete monetare dhe zëra të tjerë monetarë, kryen shpenzime, gjeneron të ardhura dhe siguron huamarrje, të gjitha kryesisht në monedhën e saj vendase; (b) nëse transaksionet me njësinë ekonomike zënë një pjesë të madhe ose të vogël të aktiviteteve të njësisë ekonomike të huaj; (c) nëse flukset e mjeteve monetare nga aktivitetet e njësisë ekonomike të huaj prekin direkt flukset e mjeteve monetare të njësisë ekonomike dhe janë menjëherë të disponueshme për t'ju paguar asaj; (d) nëse flukset e mjeteve monetare nga aktivitetet e njësisë ekonomike të huaj janë të mjaftueshme për të paguar detyrimet ekzistuese apo ato të pritshme, pa financime nga njësia ekonomike.
	<b>RAPORTIMI NË MONEDHËN FUNKSIONALE TË TRANSAKSIONEVE NË MONEDHË TË HUAJ</b>
	<b>Njohja</b>
10	Një transaksion në monedhë të huaj është ai transaksion, i cili është shprehur në monedhë të huaj ose shlyhet në monedhë të huaj, përfshirë edhe ato transaksione që rrjedhin kur njësia ekonomike: (a) blen ose shet mallra ose shërbime, çmimi i të cilave është i shprehur në monedhë të huaj; (b) merr ose jep hua, ku shumat për t'u paguar dhe për t'u arkëtuar janë të shprehura në monedhë të huaj; (c) përfiton ose heq dorë nga zotërimi i aktiveve dhe/ose merr përsipër apo shlyen detyrime të shprehura në monedhë të huaj.
11	Një transaksion në monedhë të huaj, në njohje, regjistrohet në monedhën funksionale, duke zbatuar mbi shumën e monedhës së huaj kursin e menjëhershëm të këmbimit (spot) ndërmjet monedhës funksionale dhe monedhës së huaj në datën e transaksionit.
12	Data e transaksionit është data kur transaksioni fillimisht plotëson kushtet për njohjen në përputhje me SKK-të. Për arsye praktike, shpesh përdoret një kurs këmbimi, i cili është i përafërt me kursin e datës së kryerjes së transaksionit, p.sh. një kurs mesatar i një jave ose një muaji mund të përdoret për të gjitha transaksionet e kryera gjatë kësaj periudhe, në secilën prej monedhave të përdorura. Por, nëse gjatë periudhës ka luhatje të konsiderueshme të kursit të këmbimit, përdorimi i kursit mesatar është i papërshtatshëm.
	<b>Raportimi në fund të periudhave raportuese të mëpasshme</b>
13	Në fund të çdo periudhe raportuese, një njësi ekonomike duhet: (a) të përkthejë zërat monetarë të shprehur në monedhë të huaj duke përdorur kursin e këmbimit të mbylljes (d.m.th. në datën raportuese); (b) të përkthejë zërat jomonetarë që maten me kosto historike në monedhë të huaj duke përdorur kursin e këmbimit në datën e transaksionit; (c) të përkthejë zërat jomonetarë që maten me vlerën e drejtë në monedhë të huaj duke përdorur kursin e këmbimit në datën kur është përcaktuar vlera e drejtë.
14	Nëse kursi i këmbimit mes dy monedhave është përkohësisht i padisponueshëm, atëherë do të përdoret kursi i parë pasardhës, me të cilin mund të kryhet këmbimi.
	<b>Njohja e diferencave nga kurset e këmbimit</b>
15	Kur një zë monetar rrjedh nga një transaksion në monedhë të huaj, dhe ka një ndryshim në kursin e këmbimit mes datës së kryerjes së transaksionit dhe datës së shlyerjes së tij, atëherë krijohet një diferencë këmbimi. Kur transaksioni shlyhet në të njëjtën periudhë kontabël në të cilën ai është kryer e gjithë diferenca e këmbimit njihet në atë periudhë kontabël. Kur një transaksion shlyhet në një periudhë kontabël të mëpasshme, diferenca e këmbimit ,e njohur në secilën periudhë deri në datën e shlyerjes, përcaktohet nga ndryshimi i kurseve të këmbimit gjatë secilës nga periudhat kontabël.
16	Disa SKK të tjera kërkojnë që disa përfitime dhe humbje të njihen direkt në kapital. Për shembull, sipas SKK 5 disa përfitime ose humbje që vijnë nga rivlerësimi i aktiveve afatgjata materiale duhet të njihen drejtpërdrejtë në kapital. Kur një aktiv i tillë është në monedhë të huaj, sipas paragrafit 13 (c) të këtij standardi, shuma përkatëse e rivlerësuar duhet të përkthehet duke përdorur kursin e këmbimit në datën kur përcaktohet vlera, gjë që sjell një diferencë këmbimi, e cila gjithashtu duhet të njihet në kapital.
	<b>Investimet neto në një njësi ekonomike të huaj</b>
17	Një njësi ekonomike mund të ketë një zë monetar që është i arkëtueshëm ose i pagueshëm nga/ndaj një njësie ekonomike të huaj. Një zë për të cilin shlyerja nuk është planifikuar ose nuk është e mundur në të ardhmen e parashikuar, në thelb është pjesë e investimeve neto të njësisë ekonomike në njësinë ekonomike të huaj dhe kontabilizohet në përputhje me paragrafin 18. Zëra të tillë monetarë mund të përfshijnë kërkesa të arkëtueshme afatgjata ose hua afatgjata. Ato nuk përfshijnë

	kërkesa të arkëtueshme ose kërkesa të pagueshme, afatshkurtra.
18	Diferencat e këmbimit që lindin nga një zë monetar i cili përbën pjesën e investimit neto të njësisë ekonomike në një njësi ekonomike të huaj, duhet të njihen në fitim ose humbje në pasqyrat e veçanta financiare të njësisë ekonomike raportuese ose në pasqyrat financiare individuale të njësisë ekonomike të huaj, si të jetë më e përshtatshme. Në pasqyrat financiare që përfshihen të dyja, njësia ekonomike e huaj dhe njësia ekonomike (psh pasqyrat financiare të konsoliduara kur njësia ekonomike e huaj është filial), diferenca të tilla këmbimi duhet të raportohen si pjesë e kapitalit. Ato nuk duhet të njihen prap në fitim ose humbje me shitjen ose heqjen dorë nga investimi neto.
	<b>Konsolidimi i njësive ekonomike të huaja</b>
19	Për konsolidimin e aktiveve, detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve të një njësie ekonomike të huaj me ato të njësisë ekonomike, njësia ekonomike duhet të ndjekë procedurat normale të konsolidimit, si eliminimi i tepricave dhe transaksioneve të një filiali brenda grupit (shiko SKK 9 <i>Kombinimet e bizneseve dhe konsolidimi</i> ).
20	Kur një aktiv (ose detyrim) monetar brenda grupit, qoftë afatshkurtër apo afatgjatë, eliminohet kundrejt detyrimit (ose aktivitetit) përkatës brenda grupit, atëherë njësia ekonomike duhet të paraqesë në pasqyrat financiare të konsoliduara rezultatet e ndryshimit të kursit të monedhës. Meqenëse zëri monetar përfaqëson një angazhim për të këmbyer një monedhë në një tjetër, njësia ekonomike raportuese është e ekspozuar ndaj një fitimi ose humbjeje nga ndryshimi i kursit të këmbimit të monedhës.
21	Diferencën e krijuar nga ndryshimi i kursit të këmbimit të monedhës, për zërin monetar të krijuar nga eliminimi, në pasqyrat financiare të konsoliduara, njësia ekonomike raportuese e njeh në fitim ose humbje, por nëse kjo diferencë lind nga rrethanat e përshkruara në paragrafin 18, njësia ekonomike do ta njohë atë si të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse.
22	Emri i mirë, që krijohet nga blerja e një njësie ekonomike të huaj, si dhe rregullimet me vlerën e drejtë të aktiveve dhe detyrimeve të blera, do të trajtohen si aktive dhe detyrime të njësisë ekonomike të huaj dhe do të përkthehen me kursin e mbylljes në përputhje me paragrafin 27.
	<b>Ndryshimi në monedhën funksionale</b>
23	Kur ka një ndryshim në monedhën funksionale të një njësie ekonomike, njësia duhet të zbatojë përkthimin me monedhën e re funksionale në mënyrë prospektive që nga data e ndryshimit.
24	Siç është përshkruar në paragrafët 6 deri 9, monedha funksionale e një njësie ekonomike reflekton transaksionet, ngjarjet dhe kushtet bazë që janë të rëndësishme për njësinë ekonomike. Si rrjedhim, sapo përcaktohet monedha funksionale, ajo mund të ndryshohet vetëm nëse ka ndonjë ndryshim në këto transaksione, ngjarje dhe kushte të rëndësishme. Për shembull, një ndryshim në monedhë, që kryesisht ndikon çmimet e shitjes së mallrave dhe shërbimeve, mund të çojë në një ndryshim në monedhën funksionale të njësisë ekonomike.
25	Efekti i ndryshimit në monedhën funksionale kontabilizohet në mënyrë prospektive. Me fjalë të tjera, një njësi ekonomike i përkthen të gjitha zërat në monedhën e re funksionale duke përdorur kursin e këmbimit në datën e ndryshimit të monedhës funksionale. Shumat që rezultojnë nga përkthimi për zërat jomonetarë trajtohen si kosto historike e tyre.
	<b>PËRDORIMI I MONEDHËS RAPORTUESE E NDRYSHME NGA MONEDHA FUNKSIONALE</b>
	<b>Përkthimi në monedhën raportuese</b>
26	Nëse monedha raportuese ndryshon nga monedha funksionale, njësia ekonomike duhet t'i përkthejë zërat e të ardhurave dhe shpenzimeve dhe të pozicionit financiar nga monedha funksionale në monedhën raportuese. Për shembull, kur një grup përmban njësi ekonomike individuale me monedha të ndryshme funksionale, zërat e të ardhurave dhe shpenzimeve, si dhe të pozicionit financiar të çdo njësie ekonomike, shprehen në një monedhë raportuese të përbashkët në pasqyrat financiare të konsoliduara.
27	Një njësi ekonomike, duhet të përkthejë rezultatet e saj dhe pozicionin financiar, në monedhën raportuese, duke përdorur procedurat e mëposhtme: (a) Aktivitetet dhe detyrimet për çdo pasqyrë të paraqitur të pozicionit financiar (përfshirë edhe të dhënat krahasimore) duhet të përkthehen me kursin e mbylljes në datën e raportimit. (b) Të ardhurat dhe shpenzimet për çdo pasqyrë të të ardhurave dhe shpenzimeve (përfshirë edhe të dhënat krahasimore) duhet të përkthehen me kurset e këmbimit në datat e transaksioneve. (c) Të gjitha diferencat që rezultojnë nga përkthimi duhet të njihen si zë i kapitalit. Këto diferenca, në vijim, nuk mund të riklasifikohen në fitim humbje.
28	Për arsye praktike, për të përkthyer zërat e të ardhurave dhe shpenzimeve, një njësi ekonomike mund të përdorë një kurs që i përafrohet kurseve të këmbimit në datat e transaksioneve, për shembull një kurs mesatar për periudhën. Gjithsesi, nëse kurset e këmbimit luhaten në mënyrë domethënëse, përdorimi i një kursi mesatar për periudhën është i papërshtatshëm.
29	Diferencat e këmbimit që i referohen paragrafit 27 (c) rezultojnë nga: (a) përkthimi i të ardhurave / shpenzimeve me kurset e këmbimit në datat e transaksioneve dhe i aktiveve / detyrimeve me kursin e këmbimit në datën e raportimit;

	(b) përkthimi i çeljes së aktiveve neto me kursin në datën e raportimit që ndryshon nga kursi paraardhës i raportimit.  Kur diferencat e këmbimit lidhen me një njësi ekonomike të huaj që është konsoliduar, por nuk është 100% e zotëruar, diferencat e akumuluar të këmbimit që lindin nga përkthimi dhe i takojnë interesit jokontrollues në njësinë ekonomike të huaj, njihen si pjesë e interesit jokontrollues në pasqyrën e konsoliduar të pozicionit financiar.	
	<b>SHËNIMET SHPJEGUESE</b>	
30	Njësia ekonomike duhet të paraqesë në shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare informacionin e mëposhtëm: (a) shumën e diferencave të këmbimit të njohura në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve, përveç atyre që rrjedhin nga matja me vlerën e drejtë e instrumenteve financiare, dhe që ndryshimet njihen në pasqyrën e të ardhurave e shpenzimeve, në përputhje me SKK 3; (b) diferencën neto të këmbimit të klasifikuar si një zë më vete në kapital, si dhe një rakordim të kësaj diference në fillim dhe në mbyllje të periudhës kontabël.	
31	Në paragrafët vijues 32 dhe 33 referencat ndaj “monedhës funksionale”, në rastin e një grupi, kanë të bëjnë me monedhën funksionale të shoqërisë mëmë.	
32	Një njësi ekonomike duhet të deklarojë monedhën në të cilën paraqiten pasqyrat financiare. Kur monedha raportuese është e ndryshme nga monedha funksionale, një njësi ekonomike duhet ta deklarojë këtë fakt dhe duhet të japë informacion shpjegues për monedhën funksionale dhe arsyen e përdorimit të një monedhe raportuese të ndryshme.	
33	Kur ka një ndryshim në monedhën funksionale të njësisë ekonomike raportuese ose të një njësie ekonomike të huaj të rëndësishme, njësia ekonomike duhet të deklarojë këtë fakt si dhe arsyen e ndryshimit të monedhës funksionale.	
	<b>DATA E HYRJES NË ZBATIM</b>	
34	SKK 12 <i>Efekti i ndryshimeve të kurseve të këmbimit</i> , përditësuar në vitin 2023, do të zbatohet në pasqyrat financiare që mbulojnë periudha kontabël që fillojnë më ose pas datës 01.01.2025. Kërkesat e SKK 12 (2023) do të zbatohen në prospektivë.	
	<b>TABELA KRAHASUESE</b>	
35	Tabela më poshtë tregon se si korrespondojnë paragrafët e këtij Standardi me SNRF për NVM (2015). Paragrafët janë konsideruar si korresponduese nëse ato trajtojnë në përgjithësi të njëjtën çështje pavarësisht nga fakti që seksionet e referuara mund të kenë ndryshime.	
	<b>Paragrafët e SKK 12</b>	<b>Paragrafët e SNRF për NVM botuar në korrik 2015</b>
	Paragrafi 1	Asnjë
	Paragrafi 2	Asnjë
	Paragrafi 3	Asnjë
	Paragrafi 4	Sek 30.1
	Paragrafi 5	Asnjë
	Paragrafi 6	Sek 30.2
	Paragrafi 7	Sek 30.3
	Paragrafi 8	Sek 30.4
	Paragrafi 9	Sek 30.5
	Paragrafi 10	Sek 30.6
	Paragrafi 11	Sek 30.7
	Paragrafi 12	Sek 30.8
	Paragrafi 13	Sek 30.9
	Paragrafi 14	Asnjë
	Paragrafi 15	Sek 30.10
	Paragrafi 16	Sek 30.11
	Paragrafi 17	Sek 30.12
	Paragrafi 18	Sek 30.13
	Paragrafi 19	Sek 30.22

Paragrafi 20	Sek 30.22
Paragrafi 21	Sek 30.22
Paragrafi 22	Sek 30.23
Paragrafi 23	Sek 30.14
Paragrafi 24	Sek 30.15
Paragrafi 25	Sek 30.16
Paragrafi 26	Sek 30.17
Paragrafi 27	Sek 30.18
Paragrafi 28	Sek 30.19
Paragrafi 29	Sek 30.20
Paragrafi 30	Sek 30.25
Paragrafi 31	Sek 30.24
Paragrafi 32	Sek 30.26
Paragrafi 33	Sek 30.27
Paragrafi 34	Asnjë
Paragrafi 35	Asnjë